



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 157, dt. 08.07.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.07.2016, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohen projektet e hartuara nga DRKK Berat:
 - “Restaurimi i çatisë së banesës së Nikodhim Bushit”, lagja Goricë G-132, Berat”;
 - “Restaurimi i çatisë së banesës së Piro dhe Lili Vrushos”, lagja Mangalem M-013/a dhe M-013/b, Berat”;
 - “Restaurimi i çatisë së banesës së Spiro Proj”, lagja Goricë G-031, Berat”;
 - “Restaurimi i banesës së Stefan dhe Llazar Buhurit”, lagja Goricë G-040, Berat”;
 - “Restaurimi i banesës së Kastriot Dervishit”, Berat”;
 - “Konservimi dhe restaurimi i afreskut në Kishën e Shën Triadhës, Berat.
 2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI